

Ky dokument nuk është prova. Prova janë bajtët e ruajtur: HTML-ja e faqes, pamja e saj, dhe zinxhiri i hash-eve që i lidh. Kjo dëshmi është paraqitja e tyre, e prodhuar automatikisht. Verifikohet me kodin më poshtë **pa na pyetur ne**.

ARTIKULLI

TITULLI	"Nuk e kuptoj çfarë përbindëshash jeni"/ Letra e Nazmi Berishës nga Burreli për Mehmet Shehun, dëshmia që rrëzon mitin komunist të "atdheut mëmë"
ADRESA	https://piranjat.al/aktualitet/nuk-e-kuptoj-çfare-perbindeshash-jeni-letra-e-nazmi-beris-hes-nga-burr-i103977
BURIMI	piranjat.al
GJENDJA	online

KOHA


KAPUR NGA NE	14 shtator 2026, 06:14:56 UTC <i>Dritarja jonë e pasigurisë: ± 900 s — intervali me të cilin e kontrollojmë këtë burim.</i>
DEKLARUAR NGA PORTALI	14 shtator 2026, 05:58:08 UTC <i>Koha e deklaruar vjen nga pala që po vlerësohet. Ora jonë nuk preket prej saj, dhe të dyja shfaqen këtu të ndara.</i>

HASH-ET · SHA-256

PËRMBAJTJA	caa857214e34a3fe6657edc9900bc40039eff9d68f50d6e7ee6edb3d4867ded7
TEKSTI	5114c19488a2a5f418b4a12d07a42d3307e7067631abac7f5cf2732da0236f24
PAMJA	a293ba5e8eb6b0442425abc54303e023ce083acf8273d5798ef8c448290855d2

ZINXHIRI I PROVËS

KJO HYRJE	c19fc471d7bc73279d402c2208085b878133620a32e7847d339f4f79422230de
E MËPARSHMJA	—
RRËNJA MERKLE	ffd91b584b7f6ad6fe6fe6255283fcbda7dbe303bf00ea6d85b435b755931683
ANKORIMI	submitted — dërguar, ende pa bllok <i>Deri te blloku, kjo provon integritetin, jo kohën.</i>



SKANOJE PËR TA VERIFIKUAR

Kodi të nxjerr te eksploruesi i STAMLES. Ai regjistër nuk është yni: nëse serveri ynë bie nesër, vula mbetet aty ku është.

Faqja tregon njërin nga tri gjendjet — **nuk u gjet**, **në radhë**, ose **e konfirmuar** me bllokun, rrënjën Merkle dhe transaksionin në Polygon. Krahase hash-in që gjen atje me atë të shtypur më lart: nëse përputhen, kjo kapje ekzistonte para asaj ore, dhe ne nuk mund ta kishim ndryshuar pas saj.

<https://scan.stamles.eu/verify/c19fc471d7bc73279d402c2208085b878133620a32e7847d339f4f79422230de>

PAMJA E FAQES

Renderuar nga HTML-ja jonë e ruajtur, jo nga rrjeti. **Riprodhon kopjen tonë, jo pamjen e atëhershme:** stilet dhe imazhet e largëta mund të mos ekzistojnë më ose të kenë ndryshuar.

Motori: chromium-stored+assets · dritarja 1280×1024 px



- EDITORIAL
- EMISIONE
- INVESTIGIME
- AKTUALITET
- SOCIALE
- POLITIKË
- KOSOVA
- BOTA
- SHOWBIZ
- LIFESTYLE
- SPORT

SYRI LIVE



Flash:

qytetarë në
shesh:
Rama ien

e plagos me
çekiç! Në
kërkim autori

Roskovecit,
ku një
shtetas
dushohet se

shqiptarët,
në Gjermani

serish me
ritme të
larta në 10
vitet e

temperaturat

pritet të
shkojnë deri
në 31&de...


Mesatarisht
34 mijë lekë

është
falas, po
hyrja në
të nuk

AKTUALITET

“Nuk e kuptoj çfarë përbindëshash jeni”/ Letra e Nazmi Berishës nga Burreli për Mehmet Shehun, dëshmia që rrëzon mitin komunist të “atdheut mëmë”

Pirnatat Përditësimi i fundit 14 Shtator 2026, 07:58



Ka dokumente që nuk kanë nevojë për shumë koment. Mjafton t'i lexosh fjalët dhe e kupton menjëherë se çfarë ishte në të vërtetë regjimi komunist shqiptar: jo vetëm diktaturë kundër qytetarëve të vet, por edhe një makineri e ftohtë antikombëtare, që shqiptarët e Kosovës i priti jo si vëllezër, por si armiq.

Një prej këtyre dokumenteve është letra që Nazmi Mehmet Berisha, shqiptar nga Kosova, i dërgonte Mehmet Shehut nga Burgu i Burrelit. Një letër e shkruar nga qelia, me gjuhën e një njeriu që nuk kishte më asnjë iluzion për shtetin ku kishte ardhur të gjente shpëtim. Përballë tij nuk ishte “atdheu mëmë”, por një regjim që e kishte futur në burg, e kishte lënë të pambrojtur dhe, sipas dëshmisë së tij, po ia rrezikonte jetën edhe brenda qelisë. Në mes të kësaj letre, ai shkruante një nga fjalitë më tronditëse që mund të gjenden në arkivat e komunizmit shqiptar: “Unë nuk e kuptoj se çfarë përbindëshash jeni që nuk ngopeni me gjakun e kosovarëve?”

Kjo fjali nuk është retorikë. Është aktakuzë.

Nazmi Berisha kishte ardhur në Shqipëri në vitin 1960, duke ikur nga përndjekja serbe. Si shumë shqiptarë të Kosovës, ai besoi se në anën tjetër të kufirit do të gjente shtetin shqiptar, strehën kombëtare, vendin ku fjala “vëlla” nuk ishte propagandë. Por Shqipëria e Enver Hoxhës nuk ishte atdhe për ta. Ishte një burg i jetës, shpesh edhe më mizor, sepse i godiste me emrin e kombit që pretendonte se përfaqëonte.

Nazmiu u dënua dy herë nga regjimi komunist. Vuajti gjithsej 15 vjet, 1 muaj e 10 ditë burg. Kaloi në Burrel, Rubik, Ballsh dhe në të ashtuquajturën “qendër të emigrantëve jugosllavë” në Çermë. Në 20 vitet që qëndroi në Shqipëri, siç dëshmon edhe vetë historia e tij, nuk jetoi asnjë ditë lirie. Erdhi për të shpëtuar nga dhuna e një regjimi të huaj dhe ra në duart e një regjimi që fliste shqip, por sillte si pushtues ndaj shqiptarëve të Kosovës.

Në letër drejtuar Mehmet Shehut, Nazmi Berisha nuk flet si njeri që pret mëshirë nga regjimi. Ai shkruan si dikush që e di se shteti që kishte ëndërruar si strehë kombëtare i është kthyer në kërcënim për jetën. Nga Burgu i Burrelit, ai denoncon dhunën, rrezikun fizik dhe braktisjen e qëllimshme nga komanda e burgut. Nuk kërkon privilegj. Nuk kërkon trajtim të veçantë. Ai vendos përballë kryeministrit të Shqipërisë një pyetje që sot lexohet si aktakuzë morale ndaj gjithë regjimit: “Unë nuk e kuptoj se çfarë përbindëshash jeni që nuk ngopeni me gjakun e kosovarëve?”

Letra tregon një realitet të zi të burgjeve komuniste: të burgosurit politikë lihehin në mëshirë të dhunës së të dënuarve ordinerë, ndërsa komanda shfaqej vetëm kur duhej të regjistronte pasojën, jo për të ndaluar shkakun. Shteti mund të mos vriste gjithmonë me vendim gjykatë, por dinte të vriste me heshtje, me braktisje, me sëmundje, me urinë, me frikë dhe me dorën e të tjerëve.

“Mos ua kaloni kufijtë e njerëzimit e të bëni atë që s’ka bërë asnjë komb tjetër”, shkruante ai. Dhe më tej pyeste nëse ishte “ligj i prerë për të gjithë ata kosovarë që kanë ardhur këtu” që t’u përkatte vdekja misterioze. Këto janë fjalë që rrëzojnë një gënjeshtrë të madhe historike: atë se regjimi i Enver Hoxhës ishte mbrojtës i çështjes kombëtare. Jo. Për shqiptarët e Kosovës që erdhën në Shqipëri, ky regjim shpesh ishte hetues, roje, gjykatës dhe xhelat.

Nazmi Berisha nuk ishte rast i vetëm. Ai ishte një nga shumë shqiptarët e Kosovës që kaluan kufirin me shpresën e shpëtimit dhe përfunduan në dosjet e Sigurimit si të dyshimtë, si agjentë të mundshëm, si armiq. Në logjikën paranojake të diktaturës, edhe shqiptari që vinte nga Kosova nuk ishte vëlla, por rrezik. Ishte njeri që duhej survejuar, izoluar, thyer. Kjo është një nga traditët më të mëdha morale të komunizmit shqiptar: përdori Kosovën si flamur propagande, ndërsa kosovarët realë i trajtoi si material burgu.

Pas rënies së komunizmit, Nazmi Berisha la edhe librin “20 vjet në burgjet e Enver Hoxhës”, ku dëshmoi dramën e shqiptarëve të Kosovës që erdhën në Shqipëri dhe gjetën një ferr tjetër. Ai

shkruese për jetën e tij të shkatërruar: “Për mua jeta e kishte humbur kuptimin, pa grua, pa fëmijë, pa shtëpi, pa pozitë shoqërore, pa stabilitet emocional, pa intimitet të theksuar, pa pasuri, pa afrimitet personal, pa shumëshka që jetën e bën jetë”.

Kjo është fatura njerëzore e diktaturës. Jo statistika të thata. Jo fjali muzeale. Por jetë të thyera, burra të plakur në burgje, familje të pamundura, dashuri të perealizuara, dinjitet i shtypur.

Më 8 nëntor 2022, Nazmi Mehmet Berisha ndërroi jetë në Sarpsborg të Norvegjisë, në moshën 84-vjeçare. Vdiq larg Shqipërisë që e kishte burgosur dhe larg Kosovës prej së cilës ishte larguar për të shpëtuar. Por letra e tij nga Burreli mbetet. Dhe ajo letër është më e fortë se çdo dekoratë, më e rëndë se çdo fjalim për “lavdinë” e regjimit, më e vërtetë se çdo nostalgji e neveritshme për diktaturën.

Sepse aty nuk flet propaganda. Flet njeriu i mbyllur në qeli, që e ka parë shtetin pa maskë. Flet shqiptari i Kosovës që iu drejtua kryeministrit të Shqipërisë dhe i tha, në thelb: ju nuk na shpëtuat, ju na vratë për së gjalli.

Dhe kjo është arsyeja pse komunizmi nuk mund të kujtohet me romantizëm. Nuk mund të relativizohet me fjali të tipit “kishte edhe të mira”. Një regjim që burgosi shqiptarët e vet dhe torturoi shqiptarët e Kosovës nuk ka “edhe të mira”. Ka vetëm viktima, dosje, burgje dhe gënjeshtër që ende presin të thuhet deri në fund.

Letra e Nazmi Berishës nuk është thjesht një dokument arkivor. Është një klithmë kundër një regjimi që nuk u mjaftua me vrasjen e lirisë, por kërkoi të vriste edhe besimin e shqiptarëve te Shqipëria.

Artikuj te sugjeruar

AKTUALITET 14 Shtator07:54

[AKEP ndalon klauzolat e indeksimit, rritja e çmimit të celularëve duhet të parashikohet në vlerë](#)

Autoriteti i Komunikimeve Elektronike dhe Postare (AKEP) do të ndalojë aplikimin e klauzolave të ndryshimit të tarifave, të shprehura...

AKTUALITET 14 Shtator07:46

[Sherr me babain e ish-bashkëjetueses, e plagos me çekiç! Në kërkim autori](#)

Një plagosje ka ndodhur mbrëmjen e djeshme në fshatin Suk të Roskovecit, ku një shtetas dyshohet se është goditur me &ccedi...

AKTUALITET 14 Shtator07:38

[Emigracioni/ BE ka dhënë 1.1 milionë leje qëndrimi për shqiptarët, në Gjermani numri arrin rekordin e 124 mijë](#)

Emigracioni i shqiptarëve drejt Bashkimit Europian ka mbetur sërish me ritme të larta në 10 vitet e fundit, dhe gradualisht po tejkalon va...

AKTUALITET 14 Shtator07:20

[Njihuni me parashikimin e motit për sot, ja sa do të jenë temperaturat](#)

Moti do të jetë i qëndrueshëm gjatë ditës së sotme, ndërsa temperaturat pritet të shkojnë deri në 31&de...

AKTUALITET 13 Shtator23:18

[Të shtëna me armë pranë një lokali në Greqi, dyshohet se është i përfshirë Alket Rizai](#)

Shqiptari Alket Rizai, ish-bashkëpunëtor i të shumëkërkuarit grek Vasilis Paleokostas dhe i njohur për arratisjen dy herë m...

AKTUALITET 13 Shtator23:04

[E rëndë në Patos, një person gjendet i pa jetë në oborrin e banesës](#)

Një ngjarje e rëndë ka ndodhur pak më parë në Patos. Një person është gjetur i pa jetë në oborrin e bane...

AKTUALITET 13 Shtator22:16

[“Rama na preu në besë”/ Dita e 45-së e protestës, Divjaka kundër Territoriales: Nuk pranojmë të bashkohemi me Lushnjen](#)

Divjaka vijon protestën kundra projektit të PS për shkrirjen e bashkisë dhe kalimin në varësi të Lushnjes. Identiteti, hist...

AKTUALITET 13 Shtator20:55

[KPP merr fuqi mbi koncesionet: Mund t'i pezullojë menjëherë ose...](#)

Kontratat koncesionare dhe partneritetet publik-privat do të kalojnë nën një kontroll më të fortë administrativ, pasi ...

AKTUALITET 13 Shtator18:18

[Përmytjet në Elbasan, banorët kërkojnë ndihmë: Na gjeni strehim](#)

Reshjet e dendura të shiut kanë shkakuar përmytje dhe probleme të shumta në qytetin e Elbasanit. Brenda vetëm 30 minutash, rr...

AKTUALITET 13 Shtator17:36

[“Dje thonte furnizojmë vendet në konflikt, sot premton se do të prodhojmë armë”/ Këlliçi nxjerr zbuluar ministrin Nufi: Ermal Raketa flet për trafik apo...](#)

Nënkryetari i Partisë Demokratike, Belind Këlliçi ka “nxjerrë zbuluar” ministrin e Mbrojtjes Ermal Nufi. Në një...

ME TE VIZITUARAT

BOTA 13 Shtator

["Kaos" në fluturimin Australi-Katar/ Dy burra p...](#)

Një incident është regjistruar në bordin e një fluturimi nga Melbourne drejt Dohas, ku dy pasagjerë meshkuj u bënë agre...

AKTUALITET 13 Shtator

["Dil jashtë", u përplas me Edi Ramën për "Terri...](#)

Mes debateve dhe përplasjeve, kështu është zhvilluar mbledhja e kësaj të diele mes kryeministrit Edi Rama dhe komunitetit të...

BOTA 13 Shtator

[A mund t'i mbijetojë tregu i naftës një lufte t...](#)


Lufta mes SHBA-së dhe Iranit ka zgjatur shumë më tepër nga sa pritej, por pavarësisht tronditjeve, tregu global i naftës ka tregua...

INVESTIGIME 31 Maj14:01


[Gratteri për Piranjat: Kam 38 vite që më duan të vdekur ndaj nuk dal kurrë në publik](#)

Për më shumë se tre dekada, jeta e kryeprokurorit italian të antimafias, Nicola Gratteri, ka qenë nën hijen e kërcënimev...

video



Reagon Clevio!



Reagon Clevio!



Matilda,Piranja jonë vegjetariane: gjatë javës kap të korruptuarit, të dielën thyen rekorde në male!





Pamja këtu është e ri-koduar për ta futur në dokument. Artefakti autoritar është skedari WebP i ruajtur, dhe hash-i i tij është ai i shtypur te faqja e parë — pra dallimi është i verifikueshëm, jo i fshehur.